



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim
Uprava za Obrazovanje/Department of Education

Nr. 05/ 283

Datë: 17.08.2020

Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës si dhe vendimin nr. 290/01B të datës:22.10.2012 (Korrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë të Kosovës, është i kompletuar dhe i zbatueshëm për arsimin parauniversitar të Kosovës) dhe në bazë të Vendimit të MASH Nr.1771 i datës 06.08.2020, Drejtoria për Arsim e Komunës së Shtimes shpall:

K O N K U R S

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10-të) në arsimin e mesëm të lartë për vitin shkollor 2020/2021, në Gjimnazin “Naim Frashëri” dhe në Shkollën e Mesme të Lartë Profesionale në Shtime për afatin e Gushtit

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2020/21, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen të bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASH dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron),

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes

Shkolla duhet të krijojë kushte për mbajtjen e distancës së nxënësve gjatë aplikimit të tyre

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2020/2021, bëhet më datën **17, 18, 19, 20 dhe 21 Gusht 2020** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Publikimi i rezultateve për pranimin e nxënësve :

- **24 gusht 2020 (në shkollat ku plotësohet numri)**
- **28 gusht 2020 (në shkollat ku nuk plotësohet numri i nxënësve dhe vazhdon konkurrimi).**

Kthimi i dokumenteve për nxënësit të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 24 deri më 31 gusht 2020

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë që brenda 24 orëve nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë Drejtorisë së Shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASH – Komisionit për Ankesa

Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të, duhet t'i plotësoj këto kriteret:

- Nota mesatare e të gjitha lëndëve (klasat 6-9) (60%) 60 pikë
- Nota mesatare nga lëndët prioritare (klasa 6-9) (40 %) 40 pikë
- Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 e më lartë (së pari gjendët mesatarja e 4 lëndëve prioritet veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

1. Gjimnazi i Shkencave Natyrore

Lënda I – Fizikë

Lënda II – Kimi

Lënda III- Biologji

Lënda IV- Matematikë

2. Gjimnazi i Shkencave Shoqërore dhe Gjuhësore

Lënda I – Gjuhë Amtare

Lënda II- Gjuhë Angleze

Lënda III – Histori

Lënda IV- Gjeografi

3. Shëndetësi, Bujqësi dhe Vetrinari

Lënda I – Fizikë

Lënda II- Kimi

Lënda III- Biologji

Lënda IV- Gjuhë Amtare

4. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehtari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi- Teknologji

Lënda I – Fizikë

Lënda II- Kimi

Lënda III-Matematikë

Lënda IV TIK

5. Ekonomi

Lënda I – Gjuhë Amtare

Lënda II- Gjeografi

Lënda III – Matematikë

Lënda IV – TIK

6. Juridik, Tregti, Hoteleri dhe Turizëm

Lënda I – Gjuhë Amtare

Lënda II Gjuhë Angleze

Lënda III- Histori

Lënda IV- Gjeografi

**PLANIFIKIMI PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR
2020/2021**

Gjimnazi “Naim Frashëri”

Shkolla	Drejtimi	Paralele	Nx. të planifikuar për regjistrim
Gjimnazi “Naim Frashëri”	Gjimnazi i Shkencave të Natyrës	5	150
	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore dhe Gjuhësore	3	96
Gjithsej:		8	246

Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale

Shkolla	Drejtimi	Profili	Paralele	Nx. të planifikuar për regjistrim
Shkolla e Mesme Profesionale	Makineri	Instalues i ngrohjes dhe klimatizim	1	24
		Teknik i trafikut rrugor	1	24
	Elektroteknikë	Informatikë	1	24
	Bujqësi	Agrobiznes	1	24
	Juridik	Asistent i administratës	1	24
	Ekonomi	Kontabilitet	1	24
		Banka dhe sigurime	1	24
	Ndërtimtari	Arkitekturë	1	24
Gjithsej:			8	192

Drejtoresha për Arsim,
Agimë HASANI ROSHAJ

